

RAPORT
PËR VLERËSIMIN E ZVOGËLIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
“HYDROBORSH” SH.P.K.

Në zbatim të misionit që më është ngarkuar nga shoqëria "Hydroborsh" sh.p.k, me Vendimin e Asamblesë të Ortakëve datë 02.03.2024, kam kryer misionin në lidhje me hartimin e raportit për vlerësimin e zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë në shumën prej 34.160.000 lekë nga fitimet e realizuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë në vite.

Qëllimi i vlersimit të kapitalit është vlerësimi i tij nga zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë të krijuar ndër vite nga fitimet e realizuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, pra zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë i krijuar nga fitimet e realizuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë në vite do ti nënshtrohet kërkesave të Ligjit Nr.29/2023" Për Tatimin mbi të Ardhurat", në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008" Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe kërkesat e Statutit të shoqërisë "Hydroborsh"sh.p.k.

1. Te pergjithshme

Shoqëria "Hydroborsh" sh.p.k, person juridik i së drejtës shqiptare, i regjistruar në Qendrën Kombetare të Regjistrimit në datë 28.09.2009 me seli Vlorë, Lukove Godina e HEC Fterra i Borsh.

Kapitali në momentin e krijimit të shoqërisë ishte prej 100.000 lekë dhe në vitin 2014 është shtuar kapitali i shoqërisë nga kontributet në para të ortakëve në vlerën prej 140.000.000 lekë dhe nga fitimet në vlerë prej 34.160.000 lekë duke u bërë në vlerën prej 174.260.000 lekë dhe zotëroher nga dy ortakë me pjesëmarrje secili:

- Shoqëria "Agra"sh.a., dhe zotëron prej 95% të kapitalit, i përbërë nga një kuotë,
- Shoqëria "TID"Sh.p.k. zotëron prej 5% të kapitalit, i përbërë nga një kuotë.

Shoqëria drejtohet nga administratori Z.Faik Bruçi dhe Z.Vangjel Ngjelo.
NIPT: K92129029E.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën e turizmit, Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Fterre" dhe "Fterre 1" tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, venia në pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike në zbatim të kontratës së konçesionit nr.6072 Rep, Nr.2270 Kol datë 31.05.2009.

Shoqëria ka shtuar / zmadhuar kapitalin me Vendimin e Nr.3334 Rep, Nr.1457 Kol, datë 12.08.2014, të asamblesë së ortakëve të shoqërisë me kontribute në para në vlerë prej 140.000.000 lekë dhe nga fitimet në vlerë prej 34.160.000 lekë. Në fund të vitit 2017 kapitali i regjistruar i shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit ka rezultuar në vlerën prej 174.260.000 lekë.

Kapitali i nënshkruar/regjistruar i shoqërisë në datën e hartimit të raportit është në vlerë prej 174.260.000 lekë.

Kapitali i shoqërisë në datën 02.03.2024 sipas burimit të krijimit është paraqitur në tabelën e më poshtme:



Burimi	Para Lekë	Fitime Leke	Totali Lekë
Para Cash viti 2009	100,000	0	100,000
Para Cash viti 2014	140,000,000	34,160,000	174,160,000
Totali	140,100,000	34,160,000	174,260,000

Kapitali i nënshkruar i shoqërise në datën e hartimit të raportit zotërohej nga ortakët sipas përqindjeve është si në tabelën e më poshtme:

Nr	Ortakët	% ne Kap.	Para Leke	Fitime Leke	Fitime+Para Leke
1	“Aгна”	95.00	133,095,000	32,452,000	165,547,000
2	“Tirana International Development”Sh.p.k.	5.00	7,005,000	1,708,000	8,713,000
	Totali	100	140,100,000	34,160,000	174,260,000

Verifikimi dhe vërtetimi i dokumentacionit të vlerësimit të zvogëlimit të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k,do të bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të Statutit të shoqërisë “Hydroborsh”sh.p.k, të Vendimit të Asamblesë të Ortakëve të Shoqërisë“Hydroborsh”sh.p.k, datë 02.03.2024, të Ligjit Nr.29/2023”Për tatimin mbi të ardhurat në RSH”, dhe udhëzimeve në mbështetje të këtij ligji, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”

Në vendimin e Asamblese të Ortakëve datë 02.03.2024 sipas pikave të rendit të ditës, është bërë miratimi i zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë në shumën prej 34.160.000 lekë nga fitimet e realizuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë në vite.

Nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë i cili është krijuar nga kontributet në natyrë, në para dhe fitimet ndër vite të shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k, në vlerë prej 34.160.000 lekë, kapitali i shoqërisë do të pësoje ndryshim për këtë vlerë, ndërsa përqindjet e zotërimit të kapitalit dhe përbërja e ortakëve nuk do të ndryshojë.

2. Vlerësimi i kapitalit, shkakut dhe masës së zvogëlimit.

Për përcaktimin e vlerës të zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë i cili është krijuar nga kontributet në para dhe fitimet ndër vite të shoqërisë “Hydroborsh”sh.p.k, në vlerë prej 34.160.000 lekë, është rënë dakort që do të merren parasysh burimet e krijimit të kapitalit të nënshkruar nga secili ortak.

Në bazë të vendimit të asamblesë dhe të dhënave që janë të pasqyruara në pasqyrat Financiare të shoqërisë deri me 31.12.2023 dhe në regjistrat kontabël të llogarive deri në datën e vendimit datë 02.03.2024 kapitali i shoqërisë është në vlerën prej 174.260.000 lekë.

Duke ju referuar edhe të dhënave të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së datë 02.03.2024 rezulton se burimet e krijimit të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë janë në para(CASH) në vlerë prej 140.100.000 lekë, si dhe nga fitimet ndër vite në vlerë prej 34.160.000 lekë

Nga eksperti u verifikua edhe shkakut, kushtet dhe modalitetet ligjore të zvogëlimit të kapitalit si:

- Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndryshon me vendim të asamblesë të ortakëve të shoqërisë në përputhje me përcaktimet të Statutit të shoqërisë.

- b. Në përputhje me kërkesat të nenit 41 të Ligjit Nr.29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.
- c. Në përputhje me kërkesat Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, I ndryshuar pas zvogëlimit/kalimit të vlerës të kapitalit duke e transferuar në llogaritë të ortakëve që kanë pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë “Hydroborsh”sh.p.k., plotëson kushtet:
 -aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 -shoqëria ka aktive të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- d. Sipas statutit të shoqërisë nuk ka ndonjë kusht në lidhje me kuota me përparsi pa të drejtë vote.
- e. Zvogëlimi/Paksimi i kapitalit realizohet nëpërmjet paksimit të vlerës nominale të kuotave.
- f. Kapitali I regjistruar nuk mund të pakësohet nën vlerën minimale të parashikuar në këtë ligj. Kapitali I shoqërisë pas zvogëlimit/paksimit të kapitalit nuk bie nën vlerën nominale të kërkuar nga ligji.

Kështu, duke u mbështetur në vlerën e paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, si dhe të regjistrave kontabël në vazhdimësi deri në datën e vendimit të ortakëve për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, dhe të konfirmimit të vlerës të kapitalit të regjistruar në datën e hartimit të raportit të vlerësimit të kapitalit të shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k., sipas ekstraktit të printuar nga faja web e QKB-se date 02.03.2024: “ Ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit”Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, i venë në dispozicion nga drejtimi i shoqërisë, si dhe i konfirmuar dhe nga unë në datën e hartimit të raportit në faqen WEB të QKB-së.

Kapitali i shoqërisë para zvogëlimit të kapitalit paraqitet si më poshtë:

		Në lekë
	Kapitali i Nënshkuar	174.260.000

Në vendimin e ortakëve të shoqërisë është vendosur se për përcaktimin e vlerës të kapitalit pas zvogëlimit, do të merret parasysh burimi i krijimit të kapitalit, pra natyra e kontributeve nga ortakët, atëhere nga eksperti u bë verifikimi i burimit të krijimit dhe krahasimi i këtyre vlerave të burimit të krijimit të kapitalit me vlerën që është vendosur për zvogëlim / kalim të kapitalit tek ortakët prej 34.160.000 lekë.

Përbërja e zvogëlimit/kalimit të kapitalit në formën e pjesëmarrjes në kapital të shoqërisë është nga pjesa e fitimeve të realizuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë në vite që I përkasin ortakëve sipas përqindjes të pjesëmarrjes në kapitalin të shoqërisë.
 Shuma e vendosur për zvogëlim të kapitalit prej 34.160.000 lekë është e detajuar për secilin ortakë sipas burimit të krijimit/ nga fitimet si më poshtë:

Nr	Ortakët	% në Kapital	Fitimet
1	Shoqëria”Agra”sh.a.	95.00	32,452,000
2	Shoqëria” Tirana International Development “Sh.p.k.	5.00	1,708,000
	Totali	100	34,160,000

Vlera në lekë e Kapitalit të shoqërisë “Hydroborsh”sh.p.k., i rishikuar në zbritje/paksim, pasi është kontrolluar edhe zbatimi i ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Statutit të shoqërisë, dhe cfare është vendosur në mbledhjen e asamblesë të ortakëve të datës 02.03.2024 në të cilën ortakët janë përfaqësuar 100% të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë dhe rezultati i votimit ka qënë pro 100% të votave sipas përqindjeve që zotëronin në kapital.

Kapitali I nënshkruar ishte	Kapitali i nënshkruar pas zvogelimit
174,260,000 lekë	140,100.000 lekë

Ndërsa struktura e zotërimit të kapitalit të shoqërisë”Hydroborsh” sh.p.k., dhe burimit të krijimit e rishikuar në zbritje/paksim të kapitalit do të paraqitet:

Nr	Ortakët	% ne Kap.	Para Leke	Fitime Leke	Para+Fitime Leke
1	Shoqëria”Agra”sh.a.	95.00	133,095,000	0	133,095,000
2	Shoqëria” Tirana International Development “Sh.p.k	5.00	7,005,000	0	7,005,000
	Totali	100	140,100,000	0	140,100,000

3. Konkluzione

Nga hartimi i këtij Raporti vërejmë që shuma e kapitalit që mbetet pas zvogëlimit/kalimit të vlerës të pakësuar të kapitalit tek llogaritë e ortakëve të shoqërisë paraqitet si më poshtë:

Kapitali i nënshkruar	174,260,000
Zvogëlimi i kapitalit	34,160,000
Kapitali që mbetet pas tërheqjes se fitimeve të kapitalizuara me parë në kapitalin e shoqërisë	140,100,000

7

Kapitali i nënshkruar pas zvogëlimit zotërohet nga ortakët si më poshtë:

Nr	Ortakët	% ë Kapital	Vlera nga kontributet në para Lekë
1	Shoqëria”Agra”Sh.a	95.00	133,095,000
2	Shoqëria” Tirana International Development “Sh.p.k	5.00	7,005,000
	Totali	100	140,100,000

Nga zvogëlimi i kapitalit për vlerën e pjesëmarrjes nga fitimet ndër vite nuk ka ndodhur ndryshim në strukturën e përbërjes të ortakëve në përqindjet e zotërimit të kapitalit, sipas të dhënave të mësipërme.

Sic shihet dhe nga të dhënat e mësipërme ky kapital në masen prej 140.100.000 leke është i argumentuar me masën e aktiveve qarkulluese dhe afatgjata të shoqërisë, të paraqitura në aktivin e pasqyrave financiare.

Sipas të dhënave të mësipërme ndryshimi i kapitalit të vet, të shoqërisë, nga zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në shumën prej 34.160.000 lekë, pra të kalimit në Kapital të shoqërisë nga fitimet ndër vite dhe ky zvogëlim sjell paksimin e vlerës së kuotës për secilin ortak në përputhje me përqindjet e zotërimit të kapitalit.

Raporti I vlerësimit të kapitalit të shoqërisë “Hydroborsh” shp.k. nga zvogëlimi i kapitalit realizohet duke kaluar nga llogaritë e shoqërisë tek llogaritë e ortakëve vlerën prej 34.160.000 lekë duke bërë rregullimet në llogaritë e pjesëmarrjes në përputhje me standartet të kontabilitetit. Kapitali që do të zvogëlohet prej 34.160.000 lekë do të kalojë në llogaritë bankare të ortakëve sipas përqindjeve si më poshtë :

-Shoqëria ”Agra”sha., zotëron 95% të kapitalit, dhe nga zvogëlimi i kapitalit do ti kalojnë në llogaritë bankare shuma prej 32.452.000 lekë,

-Shoqëria “Tirana International Development“ Sh.p.k zotëron 5% të kapitalit, dhe nga zvogëlimi i kapitalit do ti kalojnë në llogaritë bankare shuma prej 1.708.00 lekë.

Si përfundim Kapitali i shoqërisë “Hydroborsh”sh.p.k. nga zvogëlimi i kapitalit nga fitimet e shoqërisë ndër vite të shtuara në kapital në vlerën prej 34.160.000 lekë bëhet prej 140.100.000 lekë, pra pas zvogëlimit të kapitalit për vlerën e fitimeve të kaluara në capital rezulton se kapitali i shoqërisë bëhet prej 140.100.000 lekë (ishte 174.260.000 lekë dhe bëhet 140.100.000 lekë).

Kapitali prej 140.100.000 lekë zotërohet nga ortakët :

-Shoqëria”Agra”sha. zotëron 95% të kapitalit, ose në vlerë prej 133.095.000 lekë, i përbërë nga një kuotë me vlerë prej 133.095.000 lekë.

-Shoqëria “Tirana International Development “Sh.p.k zotëron 5% të kapitalit, ose në vlerë prej 7.005.000 leke, i përbërë nga një kuotë me vlerë prej 7.005.000 lekë.

Sarandë, me 04.03.2024

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Leze ABAZI

